

**NDREK GJINI**

# Prijësit e Rebelimit

**Kronikë pa koment**

***Janar–Mars 1997***

---

## **Parathënie**

Janë shkruar me dhjetëra libra për vitin e vrarë 1997. Janë bërë me mijëra faqe analiza e komente nga analistë, politikanë, gazetarë, nga ish-spiunë e ish-shefa sigurimi. Libra, artikuj dhe komente për këtë vit të vrarë kanë shkruar edhe grafomanë që nuk kanë pasur as një të qindtën e informacionit të domosdoshëm për të marrë përsipër një nismë të tillë, por janë nisur nga zelli i verbër politik për të shërbyer në njërin krah të politikës apo në tjetrin, me qëllimin e vetëm të përfitimit nga këto “analiza” dhe “komente” të mbiquajtura libra.

Duke respektuar punën e secilit prej tyre për hartimin e këtyre librave, them se në nismën time për të shpalosur para lexuesve Vitin e vrarë '97 nuk do t'i referohem asnjë fakti apo të dhëne të botuar në faqet e tyre. Kjo jo për faktin se kam bindjen e prerë se në to nuk gjendet asgjë e vërtetë, por sepse i kam vënë vetes një qëllim tjetër në nismën time për të shkruar këtë libër. Dhe qëllimi është paraqitja e ngjarjeve, fakteve, personazheve, viktimave dhe fitimtarëve të këtij viti të vrarë, pa asnjë lloj komenti.

Komentin dhe analizën e këtij viti të vrarë le ta bëjnë prokurorët, gjyqtarët, politikanët, historianët, analistët apo kushdo tjetër.

Ndërsa unë komentim e ngjarjeve të këtij viti të vrarë ia lë në dorë lexuesit.

**Autori**

---

## **Në vend të një prologu**

Gjatë vitit 1996, Shqipëria arriti suksese të padiskutueshme në të gjitha fushat. Integrimi i shpejtë i saj në strukturat euro-atlantike, ngritja e shpejtë ekonomike dhe sukseset e policisë në luftën kundër krimit ua kishin hequr përfundimisht të drejtën morale të majtëve për të synuar marrjen e pushtetit me mjete demokratike. Ndaj, grupet paramilitare që i kishin përgatitur për veprim që në zgjedhjet e majit '96, i instruktuan mjaft mirë për të vepruar edhe më me forcë, për të kryer akte të pastra terrori, vrasje, grabitje etj.

Megjithatë, forca e policisë dhe konsekuenca e krerëve të shtetit të asaj kohe për konsolidimin e institucioneve, funksionimin e shtetit ligjor dhe luftën pa kompromis kundër krimit bënë që shumica e këtyre bandave paramilitare të majta të përfundonin në qeli, ndërsa disa prej tyre u larguan përkohësisht nga vendi, për t'u rikthyer më vonë me mjete dhe para të dhuruara nga disa segmente të njohura antishqiptare. Ndërkohë, krerët e opozitës së majtë flirtonin pa mëdyshjen më të vogël, në dëm të çështjes kombëtare shqiptare, me organizata dhe klane mafioze, vetëm për hir të rikthimit në pushtet me çdo çmim.

Me paratë dhe eksponentët më kriminalë të këtyre klaneve antishqiptare u përgatit me kujdes terreni i pararevolucionit të armatosur të pranverës '97. Propagandimi i fajdeve si suksesi më i madh i ekonomisë shqiptare, infiltrimi në strukturat më të rëndësishme të këtyre firmave piramidale i ish-oficerëve të sigurimit dhe ish-spiunëve, si dhe pasurimi i shpejtë i një shtrese njerëzish ekstremisht të majtë përmes grabitjeve të shumave të mëdha nga këto firma piramidale, qe hapi i parë. Kjo për të vazhduar më pas me sponsorizime të hapura dhe të fshehta të shtypit dhe mediave, ku propagandoheshin shifra marramendëse

fitimi nga këto piramida, me qëllim mashtrimin e një mase sa më të madhe njerëzish. E gjithë kjo bëhej për të siguruar prapavijën, pra mbushjen e shesheve me njerëz të pakënaqur nga humbja e parave në këto firma, të cilave u kishin besuar mrekullinë e pasurimit të menjëhershëm.

Në fshehtësi të plotë ishte përgatitur edhe infrastruktura e dhunës dhe furnizimi me armë i grupeve paramilitare të majta. Ky furnizim u bë përmes dy drejtimesh. Nga jugu, me det dhe tokë, armët dhe kontingjentet e krimit vinin nga Greqia fqinje, siç qe edhe lirimi nga burgu i disa kriminelëve në zë që ishin dënuar atje me burgim të përjetshëm. Ndërsa nga veriu, kryesisht përmes Hanit të Hotit, hynë shumë armë automatike që përfunduan në Vlorë, pa përjashtuar këtu edhe disa eksponentë kriminalë të rekrutuar nga shërbimet e fshehta serbe.

Por si u realizua skenari i këtij revolucioni të armatosur? Cilët qenë aktorët kryesorë në skenë dhe në prapaskenë? Këto pyetje marrin përgjigje në mënyrë modeste nga shënimet e mia, jo të plota, të mbajtura gjatë atyre ditëve kur antikrimi dhe krimi ishin në një dyluftim të rreptë; kur shteti dhe antishteti luftonin për jetë a vdekje; kur njeriu dhe antinjeriu kacafyteshin deri në agoni; kur shqiptari dhe antishqiptari përballeshin në kufi, në qeveri e deri në parlament. Dhe, për fatin e keq të Shqipërisë, të shqiptarëve dhe të demokracisë së këtij vendi, në këtë dyluftim triumfuan krimi, antishteti, antinjeriu dhe antishqiptari.

Ky libër përmban shënimet e mia nga fillimi i janarit deri në fund të marsit 1997, të paraqitura në formë ditari, në mënyrë të përmbledhur dhe pa asnjë lloj komenti.

-----

6 Janar 1997

Ministri i Brendshëm, Halit Shamata, lëshon një urdhër ku kërkon vënien në gatishmëri të policisë dhe masa të rrepta sigurie për kontrollin e bregdetit. Kjo pasi trafiku i klandestinëve dhe drogës nga njerëzit e Sabit Brokajt, Skënder Gjinushit dhe Arben Malajt është bërë një shqetësim serioz për qeverinë dhe policinë italiane.

Shefi i komisarariatit të Vlorës, Sokol Mulosmani, bllokoi disa skafe dhe ndalon mbi dhjetë vlonjatë që strehonin klandestinët që prisnin të niseshin drejt brigjeve italiane.

Në mbështetje të këtij urdhri, komisar Mulosmani nis bashkëpunimin konkret me karabinierinë italiane, duke shkëmbyer me ta numrat e telefonave dhe fakseve. Kjo bëhet për shkëmbim informacioni sa më direkt dhe të shpejtë, me qëllim goditjen dhe parandalimin e aktivitetit të paligjshëm që kryhet në të dy anët e kufirit.

Po këtë ditë hyri në zbatim paketa antikrim që u miratua nga parlamenti vetëm disa ditë para Vitit të Ri. Kjo paketë parashikonte që dënimet për krime të rënda të jenë pa marzhe, duke u hequr mundësinë prokurorëve dhe gjyqtarëve të korruptuar për të liruar kriminelë nga burgjet përmes përfitimit të ryshfeteve.

8 Janar 1997

Një fajdexhi nga Kuçova, i quajtur Bujar Fata, shpall falimentimin e firmës së tij të quajtur "Malvasia" dhe zhduket me afro një milionë dollarë në çantë, duke lënë pa shpresë rreth 40 mijë

klientët e tij. Flitet se paratë i kishte depozituar me interesa të larta në një bankë të Turqisë.

Gjykata e Faktit Tiranë lë në burg pa afat disa doganierë që janë akuzuar për kontrabandë në pikën doganore të Kakavijës.

Nga burgjet greke vijnë informacione se policia e këtij vendi po keqtrajton të burgosurit shqiptarë.

9 Janar 1997

Ushtarakë të lartë të NATO-s takohen me ministrin e Mbrojtjes, Safet Zhulali. Ndërkohë, ministri i Brendshëm del para gazetarëve në një konferencë shtypi, ku bën bilancin e punës së vitit 1996 dhe shpall strategjinë e punës së dikasterit që drejton për luftën kundër krimit.

Efektivi i policisë së Kakavijës ndryshon 100 për qind. Qeveria mirëkupton studentët në kërkesat e tyre ekonomike dhe merren masa për zgjidhjen e këtyre kërkesave.

Në Vlorë, policia vret aksidentalisht një grua. Kjo pasi makina me të cilën ajo po udhëtonte nuk i bindet urdhrin të patrullës së policisë për të ndaluar dhe policët i pandehën për trafikantë dhe qëlluan mbi të.

10 Janar 1997

Në pikën e kalimit kufitar Kakavijë, policia greke kthen mbi 200 emigrantë shqiptarë. Policët e shtetit fqinj pretendojnë se nuk kanë dokumente të rregullta, duke u kërkuar edhe letërnjoftimet e vogla.

Emigrantët e kthyer forcërisht deklarojnë se kishin viza të rregullta, leje qëndrimi, madje edhe certifikata të rregullta me foto, të noterizuara dhe të përkthyer.

11 Janar 1997

Fluksi i kthimit me dhunë të emigrantëve shqiptarë nga Greqia shtohet në mënyrë të ndjeshme. Nga të gjitha pikat e kalimit të kufirit me këtë shtet fqinj vijnë lajme për mijëra të kthyer.

Sipas një burimi nga Kakavija, numri i të kthyerve e ka kaluar shifrën e 3000 personave, pjesa dërmuese e të cilëve me dokumentacion të rregullt dhe me viza të lëshuara nga vetë Ambasada greke.

Refugjatët e kthyer me dhunë tregojnë për keqtrajtime dhe grabitje parash nga ana e policëve grekë. Disa prej tyre tregojnë edhe se policët grekë u kanë thënë: “Shkoni në Shqipëri, rrëzoni nga pushteti Sali Berishën dhe pastaj e keni rrugën hapur për t’u kthyer sërish.”

12 Janar 1997

Një tërmet me magnitudë 4.3 ballë i shkallës Rihter godet Shqipërinë e Jugut. Dëmtohen rëndë mbi 70 shtëpi banimi.

Qeveria greke deklaroi se ka gati procedurat e ekstradimit në Shqipëri të shqiptarëve që vuajnë dënimin në këtë vend.

14 Janar 1997

Një skaf me 130 milionë dollarë është larguar me shpejtësi nga brigjet e Vlorës. Këtë lajm e emetuan disa media njëherësh, duke çuditur tërë opinionin shqiptar, pasi shifra ishte me të vërtetë marramendëse.

Mirëpo Ministria e Brendshme doli me një komunikatë për shtyp ku thuhej: "Lidhur me lajmin e largimit të një mjeti lundrues në drejtim të panjohur me rreth 130 milionë dollarë, dhënë nga disa media, Ministria e Brendshme bën të ditur se policia nuk disponon të dhëna të mjaftueshme për të provuar vërtetësinë e informacionit mbi të cilin mbështetet ky lajm."

Megjithëse lajmi u emetua më 14 janar, burime jo të konfirmuara flisnin se skafi me 130 milionë dollarë ishte larguar nga brigjet e Vlorës më 9 janar. Këtë lajm e bën të besueshëm edhe fakti që ai u emetua edhe përmes valëve të radios "Zëri i Amerikës".

Ky lajm solli, si të thuash, goditjen e parë në tërmetin e fajdeve. Në njoftimin e saj, Ministria e Brendshme garanton qytetarët se ka qenë dhe mbetet e vendosur për të goditur të gjitha llojet e trafikut të paligjshëm dhe autorët e tyre, që bien ndesh me sigurimin e jetës, pasurisë dhe veprimtarisë së qytetarëve.

15 Janar 1997

Firma huamarrëse "Sude", që i përket një gruaje 30-vjeçare me ngjyrë, të quajtur Maksude Kadëmi, shpall falimentimin. Në orën 16:20 të kësaj dite, ajo del në ballkonin e pallatit ku banonte dhe, para disa qindra kreditorëve që qëndronin aty duke thirrur "duam paratë tona", deklaroi: "Loja ime ka mbaruar. Paratë e mia nuk kanë të bëjnë me qeverinë. Kjo është një skemë

piramidale që falimentoi. Ju nuk keni asnjë arsye që paratë që humbët këtu t'ia kërkoni shtetit".

Kreditorët dhe disa të tjerë që nuk ishin të tillë qëlluan me gurë mbi forcat e policisë që qëndronin pranë pallatit të fajdexheshës.

16 Janar 1997

Qeveria Meksi, në një mbledhje urgjente, merr vendim për të ngrirë në bankat shqiptare të të gjitha niveleve të gjitha shumat në lekë dhe valutë të firmave më të mëdha huamarrëse. Me këtë vendim u ngrinë 25.5 miliardë lekë të fondacioneve "Populli", "Xhaferi" dhe firmës rentiere "Gjallica". Me vendim të posaçëm, qeveria bllokoi edhe të gjitha transaksionet hipotekare.

Qindra kreditorë të "Gjallicës" u grumbulluan në Vlorë duke demonstruar në kërkim të parave të tyre. Disa persona jo kreditorë, të futur në mes të turmës, pasi hodhën parulla politike kundër qeverisë, goditën me mjete të forta mbi forcat e policisë dhe, për pasojë, mbetën të plagosur dy policë.

Greqia ktheu qindra refugjatë shqiptarë.

17 Janar 1997

Ministri i Financave, Ridvan Bode, garanton kreditorët se paratë e firmave dhe fondacioneve të ngrira në bankat shqiptare janë të sigurta dhe do t'u kthehen kreditorëve. Gjykata lë në burg pa afat katër bashkëpunëtorët më të ngushtë të Sudes. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë garanton se, përveç parave që janë ngrirë, kreditorët do të marrin më pas edhe pjesë nga pasuritë e këtyre firmave që do të shiten si objekte, automjete etj.

Në sportelet e fondacioneve "Populli" dhe "Xhaferi" mblidhen kreditorë dhe ish-sigurimsa që nxisin për akte dhune.

18 Janar 1997

Presidenti Sali Berisha, në fjalën e mbajtur në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të PD-së, garanton familjet e goditura nga skemat piramidale se do të ndihmohen nga shteti në shumë fusha dhe deklaron se ato që kanë humbur shtëpitë në këto skema do të trajtohen me përparësi me kredi.

Policia përcakton sheshet për mitingjet që kërkohen nga kreditorët dhe PS-ja, dhe bën thirrje për zbatim të ligjeve dhe ruajtje të qetësisë, pasi ka shumë informacione se segmente të inkriminuara të së majtës shqiptare po kërkojnë të manipulojnë zemërimin e qytetarëve që kanë humbur paratë në skemat piramidale dhe po bëjnë thirrje për akte dhune dhe prishje të rendit kushtetues.

20 Janar 1997

Militantët e PS-së, disa ish-spiunë të sigurimit komunist dhe disa qindra kreditorë bëjnë një miting proteste. Ata arritën të dalin edhe në Sheshin "Skënderbej", ku më pas harruan thirrjet tradicionale për paratë e humbura në fajde dhe nisën të brohorasin në kor për Fatos Nanon. Dy militantë të PS-së, rreth të 50-ve, u lyen me bojë të kuqe për të pozuar dhe për të dhënë deklarata para kamerave të TV-ve të huaja. Më pas kjo lojë e kurdisur në zyrat e PS-së u kuptua shpejt dhe TVSH dha pamje filmike ku ata po lanin fytyrat me bojë të kuqe. Një ditë më parë kishin deklaruar në shtyp edhe Gjinushi edhe Mejdani se në

mitingun e kësaj dite do të derdhej gjak. Dhe, si për të mos dështuar në derdhjen e gjakut, ata zgjodhën rrugën e derdhjes së bojës së kuqe mbi fytyrat e disa militantëve, vetëm e vetëm për të akuzuar policinë për përdorim dhune.

Edhe në Fier u organizua një miting proteste, ku këtu, ndryshe nga çfarë u kurdis në Tiranë, qenë protestuesit që përdorën dhunë kundër forcave të policisë.

21 Janar 1997

Gjykata e Tiranës jep masa dënimi me disa ditë burg për disa nga protestuesit e së dielës që përdorën dhunë dhe për disa të tjerë jep si masë dënimi gjobë. Policia zbulon dhe kap 150 kg drogë, të tipit marihuanë. Gjermanët dorëzojnë masterplanin për ndërtimin e terminalit të Aeroportit të Rinasit, që kap vlerën e investimit fillestar prej 50 milionë DM. Qeveria ngre një Komision të Posaçëm për fajdet.

22 Janar 1997

Policia, e mbështetur në vendimin e prokurorisë, arreston presidentët e dy fondacioneve më të mëdha, “Xhaferi” dhe “Populli”, Rrapush Xhaferin dhe Bashkim Drizën. Nën hetim vihen edhe rreth 50 arkëtarë të këtyre fondacioneve. Këto firma piramidale mbyllin sportelet në Korçë, Elbasan dhe Tiranë. Kreditorët e Sudes ndjekin rrugën ligjore duke bërë padi kundër saj në Gjykatën e kryeqytetit.

23 Janar 1997

Parlamenti mbyll me ligj të veçantë aktivitetin e firmave piramidale mashtruese. Ligji parashikon dënime të rrepta për drejtuesit dhe bashkëpunëtorët e këtyre firmave, si dhe konfiskimin e pasurisë së tyre. Policia në të gjithë rrethet kryen arrestimin e 118 personave bashkëpunëtorë në këto firma piramidale, të cilët kishin përfituar përmes abuzimit. Vendoset masa e arrestit me burg për Bashkim Drizën dhe Rrapush Xhaferin.

24 Janar 1997

Rreth 3000 protestues, mes të cilëve edhe shumë paramilitarë të majtë që nuk kishin asnjë lidhje me fajdet, nisin një protestë në qendër të qytetit të Lushnjës. Më pas, këta eksponentë irritojnë dhe manipulojnë turmën dhe nisin veprime të dhunshme ndaj policisë dhe objekteve publike. Digjet godina e bashkisë dhe ajo e këshillit të rrethit, si dhe një makinë e policisë. Në këtë miting të dhunshëm plagosen rëndë tre policë të forcave speciale dhe 12 policë të tjerë marrin plagë të lehta.

Në Fier, policia arreston një shef të policisë së rendit dhe disa policë të tjerë, të cilët kishin grabitur para nga arkat e fondacionit “Xhaferi”. Shefi i Komisarariatit të Policisë së këtij rrethi shkarkohet nga detyra. Gjykata lë në burg Bashkim Drizën dhe Rrapush Xhaferin.

Presidenti Sali Berisha takon drejtuesit e Kuvendit Popullor dhe ata të Qeverisë për të gjetur rrugët më efikase për përshpejtimin e shpërndarjes së parave që ishin ngrirë në banka nga këto fondacione mashtruese. Në darkë, Berisha, në një prononcim për TVSH, u shpjegon shqiptarëve masat urgjente të marra në dobi të tyre.

25 Janar 1997

Zëvendëskryeministri Tritan Shehu shkon në Lushnjë. Një grup protestuesish të dhunshëm nuk e lejojnë atë të takohet me njerëzit, duke e mbajtur peng për disa orë në dhomat e stadiumit të qytetit, ku kishte zbritur me helikopter. Në darkë vonë ai kthehet në Tiranë.

Presidenti Sali Berisha zhvillon një takim pune me përfaqësues të partive politike shqiptare, ku diskuton rreth modaliteteve dhe rrugëzgjidhjeve të mundshme për problemin e firmave piramidale. Pas këtij takimi, pjesëmarrësit lëshojnë apele për këtë problem. Sabri Godo, kryetar i PR-së, nënvizoi se paratë nuk gjenden duke djegur bashki; Hysen Selfo, nënkryetar i Partisë Balli Kombëtar, kërkoi që njerëzit të mos mashtrohen nga spiunët dhe operativët e ish-Sigurimit të Shtetit; ndërsa Vasil Melo, kryetar i PBDNJ-së, u shpreh se shteti ka predispozitë për zgjidhjen e drejtë të problemit. Sekretari i Përgjithshëm i PS-së, Rexhep Mejdani, refuzon pjesëmarrjen në këtë takim.

Presidenti Berisha iu drejtua opinionit publik me një apel, ku u kërkonte kreditorëve të mos bien pre e propagandës së segmenteve kriminale të politikës që bëjnë thirrje për dhunë dhe gjakderdhje.

Në Gramsh, protestuesit e dhunshëm, të prirë nga krerë të PS-së, djegin disa zyra të bashkisë dhe këshillit të rrethit, si dhe shkatërrojnë një fabrikë të firmës "VEFA". Edhe në Berat, krerë socialistë, së bashku me disa persona të njohur për veprimtari kriminale, arrijnë të djegin zyrat e bashkisë dhe të këshillit të rrethit, si dhe disa makina shtetërore. Turmat e dhunshme, të drejtuar nga këto segmente, djegin edhe në Belsh godinën e

bashkisë. Në këto akte u panë në krye të turmave drejtues lokalë të PS-së, si dhe persona të njohur, të cilët, për t'iu shmangur ndërhyrjes së policisë, përdorën gra dhe fëmijë si mburojë.

26 Janar 1997

Protestuesit në Vlorë djegin bashkinë e qytetit. Atyre u printe kryetari i PS-së së Vlorës, Eduard Allushi, dhe disa “të dërguar specialë” nga Tirana. Në krye të turmës ishin edhe krerë të PS-së, PSD-së dhe PAD-së.

Opozita e majtë përgatit protesta të dhunshme në kryeqytet. Mbi dy mijë persona, mes tyre ish-operativë dhe individë të ndryshëm, të prirë nga Neritan Ceka, Skënder Gjinushi, Rexhep Mejdani etj., nisen drejt sheshit “Skënderbej”, duke goditur policinë me mjete të forta dhe gurë. Në këtë protestë thyhen shumë xhama të godinës së bashkisë dhe të Pallatit të Kulturës. Sipas deklarimeve të kohës, synimi ishte përshkallëzimi i dhunës ndaj institucioneve.

Mblidhet në seancë urgjente Kuvendi Popullor. Kryeministri Aleksandër Meksi kërkon shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, por kjo kërkesë refuzohet nga Presidenti Berisha. Ndërkohë, ai pranon kalimin në dispozicion të policisë të disa njësive të ushtrisë për mbrojtjen e objekteve shtetërore. Kryeministri Meksi deklaron se më 5 shkurt do të fillojë ndarja e parave të ngrira në banka për kreditorët.

28 Janar 1997

Vdes kardinali i parë shqiptar, Imzot Mikel Koliqi.

Rreth mesditës, mijëra qytetarë të kryeqytetit zhvillojnë një demonstrim paqësor kundër dhunës dhe shkatërrimit. Dhjetëra qytetarë vijnë me mjete pune dhe riparojnë dëmet e shkaktuara më parë. Demonstruesit vendosin xhamat e bashkisë dhe të Pallatit të Kulturës. Pjesëmarrësit përshëndeten edhe nga Presidenti Berisha.

Policia në Vlorë ndalon 14 persona si autorë të djegies së godinës së bashkisë së këtij qyteti. Ndër ta figuron edhe emri i kryetarit të PS-së së rrethit Vlorë, Eduard Allushi.

FMN i ofron ndihmë qeverisë për zgjidhjen e problemit të skemave piramidale. Leni Fischer, si kryetare e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, dënon dhunën dhe deklaron se problemet nuk zgjidhen me djegie dhe gurë.

29 Janar 1997

Në shumë rrethe të vendit, policia ndalon autorët e djegieve dhe shkatërrimeve. Opozita ngre zërin në mbrojtje të tyre, duke i cilësuar këto si arrestime politike.

Presidenti Berisha del para gazetarëve vendas dhe të huaj dhe e përshkruan fenomenin e fajdeve si një “sëmundje të lirisë”. Ai deklaron se e ardhmja ndërtohet me punë dhe jo me shkatërrim, si dhe se tregu informal nuk është nxitur nga qeveria.

30 Janar 1997

Parlamenti miraton ligjin për kthimin e parave. Përmes këtij ligji garantohet kthimi i parave të ngrira tek huadhënësit. Miratohet edhe një komision qeveritar për drejtimin e operacionit të kthimit të parave. Kryeministri Meksi deklaron se me këtë ligj mbrohen interesat e të gjithë kreditorëve.

Në Gjirokastrë protestojnë rreth 400 vetë në mënyrë paqësore. Në Tepelenë dështon një miting i thirrur nga PS-ja dhe aleatët e saj. Po në këtë qytet ndalohet nga policia një person që bënte thirrje për të sulmuar bankën.

1 Shkurt 1997

Policia ndalon edhe pesë drejtorë filialesh dhe punonjës të të ardhurave të fondacioneve "Xhaferi" dhe "Populli", të cilët nuk kishin përvetësuar shumën e mëdha parash nga aktivitetet e këtyre fondacioneve. Në disa qytete kryesore të vendit vazhdojnë mitingjet paqësore me thirrjet për të ndërprerë dhunën dhe shkatërrimet mbi institucionet.

3 Shkurt 1997

Mblidhet Këshilli i Ministrave dhe përcakton kriteret e shpërndarjes së pasurisë së fondacioneve. Prokuroria nis hetimet për kryefinancierin e kompanisë "Gjallica", Hysni Brasha.

4 Shkurt 1997

Falimenton kompania "Gjallica". Këtë e deklaroi vetë njëri prej drejtuesve kryesorë të kësaj kompanie, Fitim Gërzhalliu, në një

prononcim për TVSH-në. Presidenti i Republikës, Sali Berisha, fton në konsultë forcat politike dhe sindikaliste. Ai u deklaroi atyre se të manipulohet me elementë keqbërës, të cilët janë të gatshëm të grabisin, të trafikojnë apo të vrasin, pavarësisht nga ekzistenca e skemave piramidale apo shembja e tyre, është një përzgjedhje shumë e gabuar. Këta elementë, nënvizoi ai, menduan se erdhi mbretëria e tyre. Por ai siguroi se mbretëria e kriminit nuk do të vijë ndonjëherë në Shqipëri. Kreditorët e parë filluan të tërheqin depozitat pranë sporteleve që kishte hapur Banka e Kursimeve.

5 Shkurt 1997

Reporteri i KE-së, Kolomberg, vlerëson si mjaft të mira masat që ka marrë qeveria lidhur me situatën e krijuar nga shembja e skemave piramidale. Kryeministri Aleksandër Meksi deklaroi në një intervistë se në fazën e dytë të ndarjes së parave, kreditorët do të përfitojnë edhe nga paratë që do të sigurohen nga shitja e pronave të fondacioneve.

Në Vlorë u zhvillua një miting proteste për paratë e humbura në fajde. Në krye të protestave qenë krerët lokalë të PS, PSD dhe PAD. Eksponentë kriminelë brenda turmës së protestuesve, që nxiteshin nga këta liderë partish, kanë përdorur dhunë kundër forcave të policisë. Njoftimet nga ky qytet bëjnë të ditur për tre policë dhe dy qytetarë të lënduar lehtë.

6 Shkurt 1997

Sërish protesta në Vlorë. Disa eksponentë kriminelë të futur në turmën e protestuesve dhe të prirë nga liderët lokalë të PS, PSD

dhe PAD përdorën armë zjarri dhe lëndë eksplozive kundër forcave të policisë. Për pasojë janë plagosur tre policë, njëri prej të cilëve është në gjendje të rëndë. Policia ka ndaluar edhe disa prej menaxherëve të kompanisë "Gjallica".

7 Shkurt 1997

Kryetari i PSD-së, Skënder Gjinushi, dhe ai i PAD-së, Neritan Ceka, u shkojnë në ndihmë protestuesve të dhunshëm në Vlorë. Kriminelë të armatosur, skafistë e trafikantë droge dhe femrash, që mbajnë në krahët e tyre Gjinushin dhe Cekën, hyjnë në oborrin e shkollës së mesme të qytetit dhe kërkojnë që nxënësit të ndërpresin mësimin e të bashkohen me protestuesit. Këta liderë të politikës së majtë dirigjuan këto protesta të dhunshme edhe në mbrëmje.

8 Shkurt 1997

Sërish protesta të dhunshme në Vlorë. Persona të armatosur godasin me mjete të forta dhe me armë zjarri mbi policinë. Gjykata e Faktit e Tiranës vlerëson masat e arrestit për Fitim Gërxhalliun dhe 12 menaxherët e tij. Gërxhalliu dhe nëntë prej menaxherëve përfunduan në qeli. Ministria e Brendshme nuk u jep leje për miting në Sheshin "Skënderbej" as PD-së dhe as PS-së. Disa persona të dhunshëm, të futur mes turmës së protestuesve në qytetin e Fierit, sulmojnë dhe godasin gazetarin e Reuters-it, Benet Koleka. Ministria e Brendshme reagon ashpër ndaj këtij akti duke kërkuar që të garantohet me çdo kusht paprekshmëria e gazetarëve.

10 Shkurt 1997

Vritet në Vlorë Artur Rrustemi. Mijëra qytetarë vlonjatë u mbledhën që në orët e para të mëngjesit për të protestuar në qendër të qytetit. Elementë terroristë brenda turmës së protestuesve sulmojnë egërsisht me gurë, mjete të forta, shishe me lëndë djegëse dhe armë zjarri mbi forcat e policisë. Flitet se vrasja e Rrustemit është kryer për motive të dobëta.

Terroristë të prirë nga krerët lokalë të PS, PSD dhe PAD kanë qëlluar një grup policësh nga lartësitë, duke hedhur mbi ta mjete të forta. 15 policë të plagosur në gjendje të rëndë u transportuan në Spitalin Ushtarak të Tiranës. Artur Rrustemi është qëlluar nga persona brenda turmës së protestuesve. Për katër orë me radhë u sulmua me gurë, shishe me lëndë djegëse dhe armë zjarri edhe godina e komisarariatit të policisë.

Ka shumë të plagosur si nga policia, ashtu edhe nga protestuesit. Në darkë raportohen 81 të plagosur. Krerët e opozitës së majtë në Tiranë kanë bërë thirrje për mitingje të përditshme për rrëzimin e qeverisë me çdo mjet.

Kryeministri Meksi i kërkon Parlamentit që të vendosë gjendjen e jashtëzakonshme në Vlorë. Kryesia e Kuvendit u shpreh se nuk ka një ligj të tillë dhe për këtë i rekomandoi qeverisë që të përgatisë një projektligj të tillë dhe t'ia sjellë Parlamentit për miratim. Deputeti Bashkim Koplaku kërkoi dorëheqjen e qeverisë dhe krijimin e një qeverie tjetër të PD-së, ndërsa deputetët e Vlorës u shprehën kategorikisht kundër kërkesës së Meksit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në Vlorë.

11 Shkurt 1997

Në Vlorë bëhet ceremonia e varrimit të Artur Rrustemit. Disa terroristë brenda turmës shkëputen nga kortezhi dhe i vënë zjarrin godinës së PD-së së këtij qyteti. Pasdite mbërrijnë në Vlorë edhe Namik Dokle e Neritan Ceka. Ata mbështeten nga një grup banditësh të armatosur dhe skafistësh që bëjnë thirrje për djegie e shkatërrime. Për në Vlorë u nis edhe Sabit Brokaj, por u ndalua nga policia pasi e kishin kapur duke folur në telefon celular me disa kriminelë me emër në këtë qytet, ku po u jepte udhëzime për djegie, vrasje e shkatërrime. Ai ishte nën hetim për implikim me bandën "Hakmarrja për Drejtësi", e arrestuar para disa muajsh.

Shefi i policisë së fshehtë italiane, Alessandro Pansa, deklaroi se mafia italiane është pjesëmarrëse në trazirat e fundit në qytetin e Vlorës. Edhe shefi i antimafias, Pier Luigi Vigna, konfirmon se zyra e tij është e informuar rreth pranisë së krimit të organizuar në skandalin shqiptar. Ai nënvizon për ANSA-n se mafia italiane ka një rol në skemat shqiptare të investimit.

12 Shkurt 1997

Sërish protesta në Vlorë. Një polic i rendit në këtë qytet vritet pasdite para banesës së tij. Ndihen mungesat ushqimore në tregun e këtij qyteti. Në Tiranë, liderët e opozitës së majtë bëjnë thirrje me megafon për të dalë në Sheshin "Skënderbej". Drejtuesit e FRESH-it shkojnë nëpër shkollat e mesme dhe jo vetëm që u bëjnë thirrje nxënësve të braktisin klasat, por edhe bllokojnë hyrjet e shkollave.

13 Shkurt 1997

Në Vlorë fillon të ndihet kriza e mungesës së bukës dhe ushqimeve. Protestuesit mbajnë si simbol të tyrin tre gishtat lart, i njëjtë me simbolin serb. Kriminelët dhe banditët e armatosur tani veprojnë të pashqetësuar në këtë qytet. Gjykata e Faktit Tiranë liron Sabit Brokajn, megjithëse edhe ai vetë pranon se ka drejtuar me telefon protestat e dhunshme në Vlorë.

Grupi Britanik i Helsinkit, Human Rights Group, deklaron se opozita e majtë në Shqipëri po përgatit një grusht shteti. Drejtuesit e FRESH-it në kryeqytet ndërmarrin një aksion me telefonata anonime nëpër shkollat e mesme, ku kërkojnë me forcë ndërprerjen e mësimin. Tubime proteste bëhen edhe në Sarandë dhe Fier.

14 Shkurt 1997

Mblidhet tryeza e rrumbullakët e forcave politike të vendit. Opozita e majtë e bojkoton këtë tryezë dhe bën thirrje për vazhdimin e mitingjeve të dhunshme. Kjo tryezë hedh poshtë idenë e një qeverie teknike dhe kërkon të ulët tensionin, të evitohen konfliktet dhe të dënohen aktet terroriste.

Publikohen fakte komprometuese lidhur me implikimin e liderëve të opozitës së majtë me firmat piramidale. Mbi 90 për qind e drejtuesve të fondacioneve në rrethe dhe në Tiranë janë funksionarë të opozitës. Skënder Gjinushi, Kurt Kola dhe gazeta "Koha Jonë" rezultojnë se kanë tërhequr pranë këtyre fondacioneve shuma që kapin vlerën e dhjetëra mijëra dollarëve. Interpoli shqiptar shpall kërkimin për Gani Kadrinë dhe Shemsie Kadrinë, që flitet se janë të strehuar në Turqi.

15 Shkurt 1997

Kryetari i PS-së së Fierit, Petro Koçi, në krye të një turme protestuesish të dhunshëm në këtë qytet, që djegin e shkatërrojnë gjithçka, bën thirrje për t'i shpallur luftë Tiranës, duke ngritur lart tre gishtat e simbolit serb. Presidenti Sali Berisha takohet me qytetarë të Tiranës. Pas një fjale të tij, takimi vazhdon me pyetje-përgjigje. Ai deklaron se shembja e piramidave nuk rrëzon kapitalizmin shqiptar dhe shpjegon masat e qeverisë për lehtësimin e pasojave që solli rënia e tyre. Publikohen fakte që vërtetojnë financimin e PS-së nga fondacioni "Populli", me president Bashkim Drizën.

17 Shkurt 1997

Vazhdojnë protestat në Vlorë, Gjirokastrë, Fier etj. Në Tiranë, krerët e opozitës së majtë bëjnë përpjekje për të mbledhur njerëz, por kur shohin se dështojnë në aplikimin e skemës së dhunës që po përdoret në Jug nga militantë të majtë paramilitarë dhe kriminelë të paguar, shtyjnë disa persona në veprime të dhunshme kundër forcave të policisë.

Qeveria Meksi, në një mbledhje të saj, merr vendim të japë kredi të menjëhershme për blerjen e apartamenteve të banimit për familjet që kanë humbur shtëpitë në fajde. Për të prekurit e tjerë nga këto skema piramidale vendosen forma të tjera ndihme. Në një aksident automobilistik në një fshat të Bulqizës humbin jetën shtatë vetë, si dhe plagosen 13 të tjerë, të cilët transportohen në Spitalin Ushtarak të Tiranës.

18 Shkurt 1997

Presidenti Sali Berisha takohet me banorë të rrethit të Lushnjës në kinoteatrin e këtij qyteti. Ai garanton se fermerët e kësaj zone nuk do të paguajnë taksa për dy vjet rresht, si dhe u premtun se shumë shpejt qeveria do të shqyrtojë me prioritet shpalljen e këtij rrethi si zonë të lirë. Berisha garanton myzeqarët se do të kenë edhe shumë lehtësira të tjera në ndërtim.

Radio "Zëri i Amerikës" emeton një lajm nga korrespondenti i saj në Tiranë, Mero Baze, sikur Berisha është fishkëllyer në këtë takim dhe makina e tij është qëlluar me gurë. Në edicionet e lajmeve të mbrëmjes në radion dhe televizionin shqiptar, zyra e shtypit e Presidentit Berisha, në një njoftim të saj, nënvizon se lajmi i emetuar nga VOA për këtë ngjarje është krejtësisht i gënjeshtërt, duke shtuar se korrespondenti i VOA në Tiranë, Baze, duhet ta përgënjeshtrojë këtë lajm; në të kundërt, mund të humbasë akreditimin e tij për të ndjekur aktivitetet e Presidentit.

Deputeti italian Selva në Asamblenë Parlamentare të KE-së deklaron se opozita shqiptare po keqpërdor dhe manipulon protestuesit.

19 Shkurt 1997

Presidenti Berisha vazhdon takimet me banorë të rretheve të ndryshme. Në bashkëbisedimin e tij me qytetarë të Elbasanit, ai shpjegon masat emergjente që ka marrë qeveria për të kaluar vështirësitë e fajdeve. Ai kërkon që kreditorët të krijojnë komisionin e tyre për të verifikuar transparencën e qeverisë për fajdet. PD, nënvizon Berisha, nuk është për luftë civile, por për pajtim, dialog dhe mirëkuptim.

Në kryeqytet përkujtohet gjashtëvjetori i grevës së urisë së studentëve të Universitetit të Tiranës. Krijohet komisioni qeveritar për problemet në Vlorë. Vdes lideri suprem kinez Ten Hsiao Pin.

20 Shkurt 1997

42 studentë të Universitetit të Vlorës hyjnë në grevë urie. Ata kërkojnë dorëheqjen e qeverisë dhe kthimin e parave të humbura në fajde. Kryetari i Kryesisë së Kuvendit Popullor, Pjetër Arbnori, takon në Tiranë një përfaqësi të këtyre studentëve vlonjatë. Protestues vlonjatë dhe banditë të armatosur i mbështesin këta studentë.

Edhe Gjinushi, Dokle, Daut Gumeni, Neritan Ceka, Kurt Kola, së bashku me (zë)dhënësen e tij, Shane Mudaj, mbledhin paradite rreth dyqind militantë e ish-spiunë sigurimi në Tiranë dhe protestojnë nën thirrjet: "O djem, rrëmbeni armët, ja vdekje ja liri", duke ngritur lart tre gishtat, simbol i serbëve.

Partia Demokratike mbledh në Tiranë dhjetëra mijëra vetë në një miting paqësor në përkujtim të 20 shkurtit të vitit 1991, ditë kur u rrëzua busti i Enver Hoxhës.

21 Shkurt 1997

Rrjeti televiziv CNN njofton se presidenti i Republikës së Kosovës, Ibrahim Rugova, është propozuar si kandidat për Çmimin Nobel të Paqes.

Sali Berisha takohet me banorë të Dibrës, ku u shpjegon masat emergjente që ka ndërmarrë dhe po ndërmerr qeveria për të lehtësuar pasojat që ka shkaktuar rënia e piramidave. Studentëve

grevistë të urisë në Vlorë u shtohen edhe nëntë vetë të tjerë. Protestuesit vlonjatë mblidhen rreth godinës ku studentët grevojnë dhe solidarizohen me ta. Qeveria dërgon për studentët mjekë dhe batanije.

22 Shkurt 1997

Një student i grevës së urisë në Universitetin e Vlorës dërgohet në spital.

Studentët grevistë vizitohen nga krerët e opozitës, Gjinushi, Milo dhe vetë Daut Gumeni. Ata u folën protestuesve që qëndronin para godinës ku grevonin studentët. Milo u thotë pjesëmarrësve në tubim se në Vlorë nisi lufta dhe po në Vlorë duhet të mbarojë lufta.

Presidenti Sali Berisha takohet me qytetarë të Shkodrës, ku pasi shpjegon gjendjen, deklaron se me aktet që po kryen PPSH me emër të ri, po dëshmon se ka mbetur parti e dhunës dhe e terrorit dhe se aleanca me të është fundi i demokracisë shqiptare.

23 Shkurt 1997

Në tubimet e protestës në Vlorë e marrin fjalën edhe Skënder Gjinushi, Daut Gumeni dhe Paskal Milo dhe u bëjnë thirrje protestuesve që "me çdo mjet të përmbysin pushtetin e Berishës". Gjendja në këtë qytet dhe në disa qytete të tjera të Jugut vazhdon të mbetet e tensionuar.

24 Shkurt 1997

Gjendja në Vlorë tensionohet më tej. Shtatë studentë të grevës së urisë shtrohen në spital në gjendje të rëndë. Pas mbërritjes atje të kryetarit të PSD-së, Skënder Gjinushi, dhe Paskal Milos, turma kërcënon se do të djegë institucionet. Pas "konsultimeve" me Gjinushin e Milon, grupe të caktuara banditësh kanë shkuar në bashki, në këshillin e rrethit, në gjykatë etj., dhe i kanë kërcënuar që të ndërpresin punën ose, në të kundërt, do t'i djegin këto godina.

BE mbështet Shqipërinë. Kjo konfirmohet në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme të Bashkimit Europian. BE kërkon që qeveria shqiptare të vazhdojë reformat politike dhe ekonomike, si dhe premtion se do të mbështesë me kredi fermerët, infrastrukturën dhe bashkësitë lokale. Kjo mbledhje i kërkon opozitës së majtë në Shqipëri që të heqë dorë nga shfrytëzimi i gjendjes aktuale për qëllime politike. PD ftohet të marrë pjesë në mbledhjen e EDU në Paris. Përgënjeshtrohet një lajm i dhënë nga radio VOA për gjoja financime në shuma tepër të mëdha të PD-së nga firma "Gjallica".

25 Shkurt 1997

Vazhdojnë protestat në qytetin e Vlorës. Shkon në 14 numri i grevistëve të urisë të shtruar në spital. Në këtë qytet mbërrijnë Kurt Kola, Rexhep Meidani, Petrit Kalakula dhe Pandeli Majko. Puna në institucionet e këtij rrethi është ndërprerë menjëherë pas kërcënimeve për djegie.

Presidenti Berisha takohet me qytetarë të Beratit. Edhe këtu ai premtion heqjen e taksave për fermerët për dy vjet rresht, si dhe

shpalljen e zonës së lirë për këtë rreth. Ai shpjegon për të pranishmit mbështetjen që BE i dha qeverisë dhe shtetit shqiptar. "Ata që në shkurt të vitit 1967 rrënuan institucionet e kultit," tha Berisha, "në shkurt të vitit 1997 dogjën dhe shkatërruan institucionet e votës së lirë."

26 Shkurt 1997

Në Vlorë mbërrijnë kryetari i Bashkisë së Shkodrës, Bahri Borici, dhe Frrok Çupi, të cilët flasin para protestuesve duke u solidarizuar me veprimet dhe kërkesat e tyre.

Studentët e Universitetit të Shkodrës përgënjeshtrojnë lajmin për grevë në këtë universitet.

Presidenti Berisha takohet me qytetarë të Gjirokastrës. Në këtë takim ai i vlerëson fajdet si një ethe kolektive dhe deklaron se zgjidhja e këtyre problemeve, që u shkaktuan nga rënia e piramidave, do të bëhet vetëm në kuadrin e shtetit ligjor. Kthimin e parave nga qeveria ai e vlerësoi si një kërkesë të paligjshme.

27 Shkurt 1997

Skënder Gjinushi, me Kurt Kolën dhe Petrit Kalakulën, mbledhin rreth 300 vetë në një protestë në Elbasan. Këtu udhëheqësit e kësaj turme bëjnë thirrje që ta bëjnë Elbasanin si Vlorën.

Në Vlorë vazhdojnë protestat. Ministria e Brendshme përgënjeshton lajmin e dhënë nga disa gazeta të majta për gjoja dërgimin në Vlorë të forcave speciale të policisë nga Tirana.

Në Gjirokastrë hyjnë në grevë urie 46 studentë të Universitetit "Eqrem Çabej", në mbështetje të kolegëve të tyre vlonjatë.

28 Shkurt 1997

Këshilli Kombëtar i PD-së kandidon Sali Berishën për një mandat të ri presidencial.

Shtypi i majtë bën thirrje të hapura për luftë civile. Martin Leka shkruan në gazetën "Koha Jonë" se lufta e Vlorës filloi. "Kjo," thotë ai, "është një luftë e vërtetë ku nuk mungojnë komandantët as urdhrat. Nuk mungojnë as armiku dhe as përkrahësit, as llogoret e as zjarret; as armët e as municioni. Madje as heronjtë e saj." Në një shkrim tjetër të këtij shtypi thuhet se "në duart e protestuesve gjenden që nga automatikët, pistoletat e deri te sëpatat e hanxharët. Turma tanimë është ndërgjegjësuar për luftë".

Ndërkohë, një burim nga Vlora bën të ditur se pasdite grupe të armatosura kanë sulmuar me armë zjarri godinën e SHIK-ut në këtë qytet. Në darkë vonë, këta persona kanë hyrë në godinë dhe kanë vrarë e masakruar gjashtë punonjës të SHIK-ut.

Presidenti Sali Berisha pret një delegacion të BE-së, ku këta të fundit shprehen të vendosur për të vazhduar ndihmën për Shqipërinë dhe nuk mbështesin demonstrimet e dhunshme të opozitës.

Revoltat e dhunshme përhapen me shpejtësi në të gjitha rrethet e Jugut të Shqipërisë.

1 Mars 1997

Në Vlorë, bandat e terroristëve të armatosur, të prira nga militantë të PS, PSD dhe PAD, kanë sulmuar gjatë natës godinën e SHIK-ut, duke bërë një kasaphanë të paparë ndonjëherë. Bilanci i kësaj

tragjedie: tre të vrarë, tre të djegur dhe tre të tjerë të masakruar. Qyteti përfshihet nga një anarki e plotë. Gjashtë nga të vdekurit e natës së përgjakur janë punonjës të SHIK-ut.

Bandat e armatosura ia vunë zjarrin godinës së SHIK-ut me granata. Tre vetë u dogjën të gjallë në këtë godinë, ndërsa tre të tjerët, që mbetën të plagosur, u rrahën e u masakruan nga këta banditë derisa vdiqën. Nga Spitali i Vlorës vijnë të dhëna për 69 të plagosur, si dhe flitet se në këtë përleshje me armë kanë mbetur të vdekur edhe tre civilë.

SHIK njofton se 7 kamionë me terroristë të armatosur kanë sulmuar godinën e këtij institucioni në Vlorë. Këta terroristë, pasi kanë vrarë e masakruar punonjësit që kryenin shërbim aty, kanë grabitur armët dhe municionet që ndodheshin aty. Më pas, këta terroristë, së bashku me mijëra protestues të tjerë, sulmojnë edhe disa reparte ushtarake në këtë qytet. Asnjë rezistencë nuk u bë nga ana e ushtarakëve për mbrojtjen e reparteve. Autorët e këtyre sulmeve rrëmbyen nga këto reparte qindra e mijëra armë zjarri, midis të tjerave edhe mitralozë dhe eksploziv.

Qeveria Meksi jep dorëheqje.

Burime nga Vlora bëjnë të ditur se mbrëmë një grup terroristësh kanë marrë një punonjës SHIK-u që ishte plagosur në godinën e sulmuar dhe, duke e tërhequr zvarrë, e kanë dërguar para studentëve të urisë. Aty, një grua e shkurtër, e veshur me të zeza, me mbiemrin Hoxha, është ulur dhe ka thithur gjak nga trupi i këtij punonjësi SHIK-u derisa ai ndërroi jetë, para studentëve të urisë.

Kjo ngjarje makabre, që u shoqërua edhe me lajmin për dorëheqjen e qeverisë Meksi, është festuar nga studentët me shampanjë, uiski, çokollata dhe përqafile, megjithëse para syve të tyre ndodhej trupi i pajetë i një punonjësi SHIK-u të masakruar.

Banditë të armatosur nga Tepelena dhe Gjirokastra kanë rekrutuar dhe armatosur qindra fshatarë nga Memaliaj, Picari dhe Hormova, të cilët mbajnë të bllokuar rrugën nacionale.

Në Tiranë, liderët e “Forumit për Demokraci”, forum që përmbledh të majtët ekstremë dhe disa ish-spiunë të Sigurimit, me në krye Skënder Gjinushin, Kurt Kolën, Përit Kalakulën, Musa Uliqinin dhe Gaqo Apostolin, mbledhin disa qindra vetë në një miting proteste. Protesta nis në fushën “Ali Demi” për të përfunduar më pas në “Qytetin Studenti”. Këtu, udhëheqësit e turmës u bëjnë thirrje studentëve të bashkohen me ta. Kur shohin se studentët vetëm i vëzhgojnë nga ballkonet dhe nuk zbresin për t’u bashkuar me ta, revoltohen dhe nxisin banditët dhe militantët që kishin pas vetes për të thyer me gurë e mjete të forta xhamat e shumë godinave të këtij qyteti. Gjithashtu, tentojnë të hyjnë edhe në postën e policisë. Më pas, kjo turmë, me në krye këta liderë, drejtohet nga Ambasada e SHBA-së. Këtu, policia ndërhyr me forcë dhe i shpërndan protestuesit e dhunshëm. Nga ky konfrontim mbetën të plagosur 7 policë, si dhe disa protestues.

Ambasada e SHBA-së në Tiranë shpërndan një njoftim për shtyp, ku shpreh shqetësimin për dhunën, vrasjet dhe djegiet, si dhe bën thirrje që të mblidhen të gjitha forcat politike për të gjetur një zgjidhje sa më realiste për krizën me të cilën po përballet Shqipëria.

Njoftime për djegie e shkatërrime vijnë edhe nga Saranda, Tepelena, Gjirokastra, Delvina, Fieri etj.

Në Sarandë, banda të armatosura, që flitet se kanë ardhur nga Vlora, kanë hyrë në qytet, kanë provokuar policinë dhe më pas kanë sulmuar institucionet shtetërore, si godinën e SHIK-ut, portin, Bankën e Kursimeve dhe godinën e policisë, ku kanë marrë

rreth 400 armë. Më pas, këto banda kanë shpërthyer burgun e qytetit dhe kanë liruar 250 të burgosur që ndodheshin aty. Një pjesë e tyre kanë rrëmbyer skafet e privatëve që ishin në port dhe i kanë djegur. Pas kësaj, i kanë vënë flakën edhe bibliotekës së qytetit.

2 Mars 1997

Parlamenti shpall gjendjen e jashtëzakonshme. Po atë ditë miratohet ligji për bashkimin e SHIK-ut me Ministrinë e Brendshme. Parlamenti vendos që drejtuesi i forcave të rendit dhe SHIK-ut, për të përballuar situatën dhe për të shtypur dhunën e armatosur të bandave, të jetë gjeneral Bashkim Gazidede.

Në Tiranë, pasdite, turma njerëzish të armatosur, duke vënë përpara gra dhe fëmijë, shpërthejnë burgjet. Dalin prej aty të gjithë të dënuarit dhe të arrestuarit për krime të ndryshme. Të fundit dalin Fatos Nano dhe Ramiz Alia, pasi, siç janë shprehur, kishin frikë se ky ishte ndonjë skenar për t'i vrarë. Më vonë, ata transportohen me makina në banesat e tyre.

Në Vlorë, Sarandë, Tepelenë, Gjirokastër dhe disa qytete të tjera të Jugut vazhdojnë dhuna, djegiet dhe shkatërrimet.

Rrëmbehet në Sarandë një anije luftarake nga banditët e armatosur dhe sillet në Gjirin e Sarandës. Pushtohet dhe grabitet reparti ushtarak i Rusanit dhe ai i Bajkajt. Sulmohet dhe vidhet i gjithë prodhimi i ndërmarrjes së qilimave. Digjet godina e INSIG-ut.

Në Gjirokastër digjet godina e komisariatit të policisë, një zyrë në godinën e prokurorisë, si dhe grabiten dyqane e magazina. Banditët e armatosur shtijnë në ajër dhe në drejtime të

papërcaktuara, si dhe përdorin eksploziv. Nga këto të shtëna mësohet se ka mbetur i vrarë një person dhe janë plagosur katër të tjerë. Studentët e Universitetit “Eqrem Çabej” ndërpresin grevën e tyre vullnetarisht.

Në Levan të Fierit, banditë të ardhur nga Vlora sulmojnë një repart ushtarak dhe marrin gjithë armatimin dhe gjithçka tjetër që ndodhej aty.

Grupe të armatosura sulmojnë qendrën e Delvinës, duke djegur komisaratin e policisë, bashkinë dhe Bankën e Kursimeve, ku rrëmbejnë të gjitha paratë.

Në Ballsh, një grup banditësh të armatosur shkëmbejnë zjarr për disa orë me policinë.

3 Mars 1997

Parlamenti zgjedh për herë të dytë Sali Berishën President të Shqipërisë.

Dhuna, terrori, djegiet dhe shkatërrimet e bandave të armatosura kanë pushtuar pothuajse tërë Jugun e Shqipërisë. Në Vlorë digjet qendra e informimit profesional, një godinë e ndërtuar sipas një projekti danez që ka kushtuar 7 milionë dollarë. Bandat e armatosura kontrollojnë çdo lëvizje në qytet. Shtihet me armë nga të gjitha drejtimet. Nga të shtënat e pakontrolluara mësohet se kanë humbur jetën dy persona: një 18-vjeçar me emrin Luan dhe një tjetër rreth 40 vjeç, me mbiemrin Duçka.

Në Gjirokastër, një grup prej afro 100 vetësh të armatosur kanë grabitur plotësisht Adipetrolin dhe më pas e kanë shkatërruar dhe djegur.

Komandanti i gjendjes së jashtëzakonshme, Bashkim Gazidede, urdhëron mbylljen e shkollave të të gjitha niveleve në të gjithë vendin.

Italia evakuon të huajt nga Vlora.

Berisha pret ambasadorët e vendeve të BE-së. Ndërsa Presidenca e SHBA-ve lëshon një deklaratë përmes zëdhënësit Michael McCurry, ku i bën thirrje qeverisë të ruajë angazhimin për reforma ekonomike serioze dhe vlerëson përpjekjet e Presidentit Berisha për reformimin e vendit.

Në Lezhë, të burgosurit e burgut të Shën Kollit mbajnë peng drejtorin e burgut dhe tentojnë të shpërthejnë burgun. Nga përleshjet me policinë plagosen 4 të dënuar.

Në Tiranë digjet kati i parë i godinës së gazetës “Koha Jonë”, ku dëmet materiale arrijnë në mijëra dollarë.

Në shumë rrethe të vendit, turma të prira nga krerët lokalë të PS-së, PSD-së dhe PAD-së, duke vënë përpara gra dhe fëmijë, sulmojnë depot e armatimit dhe, pasi i shpërthejnë, marrin të gjithë armatimin dhe materiale të tjera ushtarake e lëndë eksplozive.

Dy pilotë të Ministrisë së Mbrojtjes, të cilët ishin ngritur me avion me mision për inspektimin e zonës, e ulin avionin në aerodromin ushtarak të Leçes në Itali dhe kërkojnë strehim politik. RAI njofton se autoritetet ushtarake italiane nuk kanë gjetur në avionin mësimor shqiptar asnjë lloj armatimi.

4 Mars 1997

Në Vlorë vazhdon të mbretërojë një gjendje kaotike. Bandat e armatosura vazhdojnë të shëtisin lirshëm nëpër qytet; ngado dëgjohe vetëm krisma armësh të kalibrave të ndryshëm dhe shpërthime eksplozivi. Grabitën shumë dyqane e njësi shërbimi. Njësi të tjera mbyllen. Mijëra qytetarë janë mbyllur brenda. Ndërsa qindra banditë të armatosur dhe prijësit e tyre politikë grabisin dhe më pas djegin kompleksin ushqimor të Kompanisë VEFA. Banorë të qytetit dhe të periferisë së Vlorës u sulen magazinave të rezervave të shtetit te Pusi i Mezinit dhe, pasi shpërthejnë dyert, grabisin prej aty tërë sasinë e grurit, që burimet zyrtare nga Tirana e vlerësojnë në masën e 3000 tonëve.

Në Sarandë vritet një shofer taksie, ndërkohë që po transportonte pasagjerë për në Kakavijë.

Lirohet nga detyra Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Gjeneral Sheme Kosova.

Presidenti Sali Berisha pret në takim përfaqësuesit e Partisë Socialiste, Mejdani, Dokle e Majko. Në këtë takim ai u kërkon atyre që të dorëzojnë para drejtësisë drejtuesit e forcës politike që ata përfaqësojnë, të cilët janë marrë me organizimin e rebelimit të armatosur, si dhe t'u bëjnë thirrje rebelëve të armatosur që të dorëzojnë armët.

Në Cerrnicë të Tropojës zhvillohet ceremonia e varrimit të punonjësit të SHIK-ut, Lekë Cokaj, i cili u masakrua në Vlorë nga banditët e armatosur që sulmuan dhe dogjën godinën e SHIK-ut në këtë qytet.

5 Mars 1997

Qyteti i Vlorës vazhdon të përjetojë kaos dhe terror. Bandat terroriste kanë pushtet absolut mbi gjithçka në këtë qytet. Në qytet është e vështirë të gjesh bukë, pa bërë fjalë për artikuj të tjerë të domosdoshëm që janë grabitur nga terroristët në ditët e mëparshme. Burime nga ky qytet kanë njoftuar për dy të vdekur dhe 19 të plagosur. Emrat e të vrarëve janë Alfred Guri, 37 vjeç, dhe Gëzim Veliu, 32 vjeç.

Në një lokal afër Komisarariatit të Policisë gjendet një sasi e konsiderueshme armësh të rënda dhe të lehta, si dhe mjaft municion. Nuk dihet se kush i ka lënë dhe për çfarë janë përdorur. Sërish dëgjoen të shtëna armësh dhe shpërthime eksplozivi. Qytetarët janë mbyllur nëpër shtëpi.

Në Elbasan dhe Librazhd policia kap disa prej të burgosurve të larguar nga burgu i Sarandës. Në Fier mblidhen mbi 3500 armë të kalibrave dhe llojeve të ndryshme. Flota detare italiane shpëton pesë shqiptarë në det.

Vendet perëndimore fillojnë të vihen në lëvizje për të ndaluar trazirat në Shqipëri.

6 Mars 1997

Presidenti Sali Berisha fton partitë politike për të diskutuar lidhur me situatën në vend. Në fund të këtij takimi, në deklaratën e përbashkët të nënshkruar nga të gjitha partitë pjesëmarrëse, thuhet:

1. Partitë politike mbështesin rivendosjen e rendit kushtetues dhe garantimin e rendit publik në të gjithë vendin.

2. Ato u kërkojnë të gjithë qytetarëve, anëtarëve dhe simpatizantëve të forcave politike të dorëzojnë armët dhe të gjitha armatimet brenda një afati kohor prej 48 orësh, duke filluar nga ora 6:00 e datës 7 mars 1997, ose të ndihmojnë dhe të influencojnë në dorëzimin e armëve brenda këtij afati, si dhe në rivendosjen e rendit dhe qetësisë.
3. Ato i kërkojnë Presidentit të Republikës të dekretojë faljen e të gjithë atyre personave që dorëzojnë armët gjatë këtij afati kohor dhe që nuk kanë kryer drejtpërdrejt krime.
4. Ato i kërkojnë Këshillit të Mbrojtjes të urdhërojë ndërprerjen e operacioneve ushtarake sulmuese në zonat ku janë parashikuar për 48 orë, duke filluar nga ora 6:00 e datës 7 mars 1997.
5. Presidenti i Republikës të fillojë konsultimet për emërimin e kryeministrit të ri, duke synuar një konsensus sa më të gjerë të mundshëm.
6. Të krijohet një komision me ekspertë të të gjitha forcave politike për të realizuar transparencën e plotë të skemave piramidale.
7. Partitë vendosën ta mbajnë të hapur dialogun.

Presidenti Berisha, me propozim të partive politike, në mbrëmje dekreton faljen për të gjithë ata persona që deri më datë 9 mars, në orën 6:00 të mëngjesit, dorëzojnë armët dhe armatimin e rrëmbyer dhe që nuk kanë kryer drejtpërdrejt krime. Edhe Këshilli i Mbrojtjes, bazuar në këtë deklaratë të partive politike, vendosi të ndërpresë veprimet operationale dhe të mbajë trupat në gatishmëri.

Vlora vazhdon të jetojë nën pushtimin e bandave.

25 të vrarë janë shënuar në këtë qytet brenda harkut kohor të një jave. Bëhet e ditur se gjendja e furnizimit me ushqime është përkeqësuar dukshëm. “Kallashë gjen shumë lehtë edhe me 200 lekë copën”, thotë një telefonues nga ky qytet, ndërsa bukë jo.

Afër mesnatës vjen një raport i hollësishëm nga Vlora. Janë shtatë vetë të vrarë nga përleshjet mes bandave rivale të këtij qyteti.

Emrat e të vrarëve janë: Leonard Golemi, 20 vjeç; Polizoi Gjini, 37 vjeç; Arben Osmani, 21 vjeç. Alfred Guri dhe Gëzim Veliu janë dërguar të vdekur në spital. Veldin Tafili, 72 vjeç, dhe Dorian Larushi, 16 vjeç, janë dërguar në spital të plagosur rëndë me armë zjarri dhe më pas kanë vdekur. Në Spitalin e Vlorës janë mjekuar gjatë ditës deri në mbrëmje vonë edhe 24 persona të tjerë të plagosur me armë zjarri dhe më pas janë larguar për në shtëpi.

Bandat terroriste jo vetëm që shtijnë nga të gjitha drejtimet dhe grabisin, por edhe nuk lejojnë qytetarët të largohen nga ky qytet.

Prokuroria e Përgjithshme merr në përgjegjësi penale ushtarakët që kanë dezertuar, duke lënë repartet ushtarake në dorë të banditëve të armatosur. Për disa prej tyre u prenë edhe fletë-arrestet. Ushtarakët e marrë në përgjegjësi penale janë Edmond Zhupani, Roland Nasto, Shahin Muhaj, si dhe dy ish-pilotët Ardian Elezaj dhe Agron Dajçi, që me avionin e tyre “MiG-15” dezertuan duke u larguar për në Itali.

SHBA mbështet deklaratën e partive politike dhe deklaron se nuk do t’i evakujë amerikanët nga Shqipëria.

Në Tiranë mbërrijnë diplomatë të OSBE-së për të përgatitur vizitën e Franz Vranitzkyt.

7 Mars 1997

Në Vlorë shënohen edhe dy të vrarë. Qyteti vazhdon të mbetet nën administrimin e plotë të rebelëve të armatosur, që lëvizin nëpër qytet edhe me tanke, mitralozë dhe armë të tjera të rënda.

Krerët e rebelëve të armatosur, që drejtohen nga drejtuesit lokalë të PS, PSD dhe PAD, si dhe disa ish-oficerë të Sigurimit të Shtetit dhe disa ushtarakë të liruar së bashku me dezertorët e ushtrisë që janë bashkuar me ta, e kanë hedhur poshtë deklaratën e partive politike të një dite më parë. Ata janë shprehur kundër dorëzimit të armëve dhe fillimit të dialogut.

Në kazanë plehrash dhe vende të tjera publike gjenden shumë armë të hedhura nga qytetarët që, me sa duket, janë solidarizuar me këtë deklaratë të partive politike, por nuk kanë pasur një vend të caktuar për t'i dorëzuar këto armë, pasi në këtë qytet nuk funksionon asnjë institucion, përveç këtyre rebelëve që drejtojnë situatën.

Nga Saranda largohen për në Korfuz me anije 80 persona që ikin prej masakrave të rebelëve të armatosur.

Edhe nga Vlora largohen për portin e Otrantos disa qindra qytetarë. 30 prej tyre kërkojnë strehim politik, duke deklaruar se ua kanë blerë me 30 mijë dollarë rebelëve të armatosur anijen me të cilën janë larguar nga ky qytet.

Në Durrës vritet një 47-vjeçar i quajtur M. Prifti.

Ministri i Jashtëm i Hollandës, Hans van Mierlo, që është kryetari i radhës i Këshillit të Ministrave të BE-së, takohet me Presidentin Berisha dhe deklaron mbështetje për përpjekjet e tij për zgjidhjen e krizës. Ai, në një konferencë për shtyp, dënon përdorimin e armëve për marrjen e pushtetit.

8 Mars 1997

Vlora vazhdon të jetojë nën terrorin e bandave të rebelëve të armatosur. Me qindra e qindra qytetarë, natën e ditën, largohen të tmerruar nga ky qytet. Nga shkëmbimi i zjarrit midis bandave që lëvizin nëpër qytet, vritet Alban Malaj, si dhe plagoset rëndë Martin Dedaj. Plagoset nga pakujdesia edhe Ilir Qejvani, për të cilin thuhet se është jashtë rrezikut për jetën. Qytetarët qëndrojnë të mbyllur brenda. Dyqanet janë të kyçura. Është shumë e vështirë të gjesh bukë, miell apo edhe sende të tjera ushqimore. 140 familje nga Vlora strehohen në Elbasan, dhe qindra e qindra të tjera në Tiranë, Durrës e deri në Shkodër.

Presidenti Berisha bën dy takime radhazi me dhjetë partitë politike, ku diskutohet deri pas mesnate rreth mënyrës së zgjidhjes së krizës. Gjithashtu zhvillon edhe dy takime me Franc Vranickin, i cili sapo ka mbërritur në Tiranë në krye të një delegacioni të OSBE-së. Vranicki kërkon shtyrjen e afatit të ultimatumit për dorëzimin e armëve dhe institucionalizimin e dialogut midis partive politike.

9 Mars 1997

Partitë politike të ftuara në takim nga Presidenti i Republikës, Sali Berisha, nënshkruajnë Marrëveshjen e Paktimit Kombëtar.

Në këtë marrëveshje thuhet: “PD, PS, PR, PBDNJ, PBK, PSD, PAD, PBSD, PLL dhe PDK bien dakord që:

1. Parlamenti shqiptar të shpallë amnistinë e përgjithshme për të gjithë ata civilë dhe ushtarakë që u implikuan në revoltën e fajdeve.

2. Të krijohet një Qeveri e Pajtimit Kombëtar me përfaqësimin e të gjitha forcave politike në dialog.
3. Brenda një afati njëjavor të dorëzohen armët dhe municionet nga të gjithë qytetarët në të gjitha rrethet e Shqipërisë.
4. Dita e diel, datë 16 mars, të shpallet ditë zie kombëtare për të nderuar të gjithë ata që humbën jetën gjatë kësaj periudhe.
5. Të zhvillohen zgjedhjet parlamentare në një periudhë jo më larg se muaji qershor 1997.
6. Zgjedhjet parlamentare të zhvillohen nën mbikëqyrjen e plotë ndërkombëtare.
7. Qeveria, në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare dhe të vendit, duhet të marrë të gjitha masat për të ndihmuar me përparësi zonat e dëmtuara.
8. Të fillojë lehtësimi i gjendjes së jashtëzakonshme, deri në heqjen sa më të shpejtë të saj.
9. Partitë të vazhdojnë dialogun.”

Kjo marrëveshje firmoset nga Presidenti i Republikës, Sali Berisha, dhe përfaqësuesit e dhjetë partive politike pjesëmarrëse në këtë takim. Marrëveshjes i bashkëngjiten edhe dy shënime: i pari ka të bëjë me kërkesën që të gjitha partitë politike i bëjnë Partisë Socialiste për t'u futur në parlament, dhe i dyti me një pretendim të Partisë Balli Kombëtar, e cila deklaron se është dakord me të gjitha pikat e kësaj platforme, por vlerëson që qeveria duhet të quhet Qeveri e Mirëkuptimit Kombëtar.

Më pas, Sali Berisha takon ministrin e jashtëm italian Dini, i cili e përshëndet arritjen e kësaj marrëveshjeje. Edhe SHBA, përmes

radios “Zëri i Amerikës”, shprehen se janë shumë të kënaqura me këtë marrëveshje.

Pasiguria, ankthi dhe krismat kanë pushtuar shumë qytete të vendit. Bandat e rebelëve të armatosur kanë hapur shumë depo armësh në qytetet kryesore të Jugut. Drejtuesit e këtyre bandave bëjnë thirrje për të marshuar drejt Tiranës.

Flitet se në Vlorë, Sarandë dhe Gjirokastër ka shumë të plagosur me armë zjarri dhe lëndë eksplozive.

10 Mars 1997

Në Vlorë, tetë përfaqësues të bandave të armatosura që drejtuan shpërthimin e depove dhe shkatërrimin e reparteve ushtarake, të cilët pasi bllokuan veprimtarinë e pushtetit lokal krijuan të ashtuquajturin Komitet Shpëtimi, u takuan në anijen “San Xhorxhia” me ambasadorin e Italisë në Shqipëri, Paolo Foresti. Pjesëmarrësit në këtë takim në det firmosën një deklaratë, duke shprehur miratimin për marrëveshjen e pajtimit kombëtar të arritur mes Presidentit Berisha dhe partive politike, dhe u angazhuan për dorëzimin e armëve dhe rikthimin e një normaliteti administrativ. Deklarata firmoset nga Luiza Hoxha, Gjergj Muço, Neshat Merkaj, Luftar Petroshati, Edmond Tahiraj, Thoma Vasili, Dashamir Bejo, Albert Bukri, si dhe në fund ka firmosur edhe Paolo Foresti me përkthyesin e tij Ilir Mati.

Në Tiranë ndihet një terror i vërtetë. Vijnë lajme se janë nisur drejt kryeqytetit për të vrarë, djegur e shkatërruar gjithçka disa qindra banditë të armatosur nga Vlora dhe disa qytete të tjera të Jugut.

Në Kuçovë shkatërrohen disa reparte ushtarake dhe nga të shtënat e pakontrolluara plagosen tetë persona.

Në Kordhoc të Gjirokastrës, banditët e armatosur, pasi e grabisin, e hedhin në erë një depo armësh dhe eksplozivi. Zhurma dhe tronditjet janë ndier deri në disa lagje të qytetit. Banorët e fshatit u larguan që para shpërthimit, pasi e parandjenë rrezikun. U plagos një plak dhe disa fëmijë. Edhe në Tepelenë, Memaliaj e Delvinë shpërthehen disa reparte ushtarake dhe grabiten prej andej të gjitha armatimet dhe municionet.

Grupe banditësh të armatosur sulmojnë dhe grabisin edhe repartin ushtarak të Ardenicës në Lushnjë.

Nga Berati vijnë lajme për plagosjen e pesë vetëve nga të shtënat e pakontrolluara të armëve; njëri prej të plagosurve thuhet se është fëmijë.

Afër mesnatës mësohet edhe për katër të plagosur të tjerë në Gjirokastrë: Kahreman Duro, 70 vjeç; Klodian Myrtezai, 11 vjeç; Kriston Cavo, 12 vjeç; dhe Siri Llocko, 40 vjeç.

Drejtori i TVSH-së, Qemal Sakajeva, jep dorëheqjen. Nëpër kryeqytet qarkullojnë lista dënimesh me vdekje për disa gazetarë të shtypit dhe të medias.

11 Mars 1997

Bashkim Fino i PS-së zgjidhet kryeministër i qeverisë së Pajtimit Kombëtar. Parlamenti miraton amnistinë e përgjithshme sipas marrëveshjes së nënshkruar dy ditë më parë nga partitë politike. Ky ligj është pikë për pikë i njëjtë me ato që janë shkruar në marrëveshjen e 9 marsit për këtë çështje.

Gjendja në kryeqytet dhe në shumë rrethe të vendit ka dalë jashtë kontrollit. Janë thyer e grabitur shumë depo armatimi në Jug. Bandat e armatosura kanë sulmuar, përveç bashkive e

prefekturave, edhe shumë godina të komisariateve të policisë. Janë grabitur magazina, dyqane e fabrika. Gjendja e ankthit, pasigurisë dhe frikës ka pushtuar edhe Tiranën. Dëgjoen krisma e shpërthime të fuqishme. Vijnë lajme për të vrarë e të plagosur. Shumë zyrtarë e intelektualë largohen nga vendi.

Në Berat, turma banditësh të armatosur sulmojnë dhe grabisin depot me grurë. Në qytet shëtisin vetëm banditët, duke shkatërruar lokale e duke grabitur.

Në darkë na vjen lajmi se një shqiptar, i quajtur Fiqiri Musati, 31 vjeç, ka vdekur në spitalin e Janinës pasi ishte goditur për vdekje në pikën e kalimit të kufirit në Kakavijë, pikë e cila ishte pushtuar nga banditë me maska nga Gjirokastra dhe fshatrat përreth.

12 Mars 1997

Gjendja tensionohet së tepërmi jo vetëm në Jug, por edhe në qytete të tjera të vendit. Edhe periferia e kryeqytetit përfshihet nga anarkia, grabitjet, krimet e armëve dhe shpërthimet.

Vijnë lajme sikur nga Vlora janë nisur dhe po marshojnë në drejtim të Tiranës me qindra e qindra banditë të armatosur. Flitet se kanë edhe mjaft armë të rënda e madje edhe tanke. Në shumë institucione ndërpritet puna. Pak telefona dikasteresh përgjigjen. Shënohen disa të plagosur si dhe dy të vrarë në kryeqytet.

Ministria e Brendshme dërgon në radio e TVSH për të bërë publik për qytetarët numrat e telefonit të dikasterit që janë në gatishmëri numër një, si dhe të të gjitha komisariateve të policisë së Tiranës.

Nga rrethet na vijnë lajme të pakonfirmuara për lloj-lloj ndodhish. Ato kanë më shumë trajtën e thashethemeve terrorizuese. Flitet

për të vrarë e të plagosur, si nga pakujdesia ashtu edhe në dyluftime mes bandave rivale.

13 Mars 1997

Anarki e plotë. Krisma dhe shpërthime dëgjoen nga çdo anë, edhe në kryeqytet. Nuk kemi lajme nga Jugu e as nga shumë rrethe të tjera të vendit. Në Tiranë ka vetëm lëvizje sporadike të ndonjë makine. Shumë pak vetë kemi kaluar natën në zyrat e Ministrisë së Brendshme. Gjithashtu, edhe në komisaritet e policisë ka pasur mjaft pak policë.

Shefi i Komisaritetit të Policisë Nr. 2 të Tiranës, Sali Shehu, zotohet se do t'i mbrojë institucionet e kryeqytetit dhe tërë kryeqytetin me çdo kusht, pavarësisht nga shmangiet në detyrë të policëve.

Një vartës i tij, i quajtur Vaidin Lame, vjen në mëngjes në Ministri dhe kërkon që të ndërhyjmë pranë TVSH-së që të jepet drejtpërdrejt një patrullim që ai ka përgatitur me policët më trima të kryeqytetit dhe me rreth 50 të rinj "që e duan me zemër Shqipërinë" (siç u shpreh ai). Para se të niseshim për në TVSH, ai më tregoi edhe rrugët që do të përshkonte kjo forcë policësh dhe të rinjsh atdhetarë, të cilët do të qëndronin hipur mbi mjete të blinduara për t'u dhënë shpresë banorëve të kryeqytetit se jeta do të vazhdojë normalisht dhe se ky qytet nuk do të bjerë nën pushtetin e bandave dhe maskave.

Ashtu u bë. Për katër orë me radhë ata demonstuan forcë, siguri dhe garanci në kryeqytet, duke ua fikur edhe shpresat e fundit atyre banditëve të cilët ishin urdhëruar për të pushtuar institucionet si në Vlorë dhe në shumë qytete të tjera të Shqipërisë.

Krerët e rebelimit dhe disa zyrtarë të qeverisë, të parlamentit dhe mediave u larguan nga Shqipëria. Të gjitha këto lajme na vinin në rrugë private, megjithëse prej katër ditësh disa nëpunës qëndrojmë për afro 20 orë pa lëvizur nga zyra, vend ky ku këto lajme në ditët normale vijnë me shumicë në rrugë zyrtare.

Banditë të armatosur kanë grabitur e më pas djegur disa ambiente të Universitetit Bujqësor në Kamëz, si dhe kanë sulmuar disa reparte ushtarake duke grabitur prej aty armë dhe municione.

Mbyllet Aeroporti i Rinasit.

14 Mars 1997

Mbrëmë pas mesnate mësuam se në disa prej komisariateve të policisë të kryeqytetit kishin hyrë disa persona të cilët pretendonin se do të merrnin drejtimin e këtyre komisariateve. Nëpunësit dhe oficerët e pakët që ndodheshin aty vetëm lajmëruan me telefon dikasterin e Ministrisë së Brendshme për këto zhvillime dhe nuk rezistuan me armë për të mos shkaktuar gjakderdhje, pasi e kuptuan fare mirë se kush ishin këta persona dhe kë përfaqësonin.

Dhe “lavdia” e këtyre “trimave të vonuar” zgjati vetëm pak orë. Në mëngjes, forcat speciale të Ministrisë së Brendshme, së bashku me djemtë atdhetarë që kryen patrullimin një ditë më parë, u kthyen legjitimitetin këtyre komisariateve duke dëbuar drejtuesit e natës dhe duke risjellë në drejtim përfaqësuesit e emëruar nga Ministria e Brendshme.

Gjatë gjithë natës dhe sot ditën janë dëgjuar të shtëna të shumta dhe shpërthime të fuqishme. Flitet për disa dhjetëra të plagosur, si dhe për tre të vrarë. Vijnë lajme se edhe në disa rrethe të

Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut janë hapur reparte ushtarake dhe depo armatimi, nga ku është rrëmbyer gjithçka.

15 Mars 1997

Lajmet për hapjen e depove ushtarake në qytetet e veriut dhe verilindjes konfirmohen. Ka shumë lajme edhe për të vrarë aksidentalisht nga përdorimi i pakujdesshëm i armëve, si dhe për larje hesapesh. Të plagosurit nga këto rrethe janë me dhjetëra.

Në Tiranë ka nisur të kthehet normaliteti. TVSH dhe Radio japin mesazhe shprese e pajtimi nga individë e intelektualë të ndryshëm. Këto media japin edhe numrat telefonikë të komisariateve të policisë dhe Ministrisë së Brendshme, ku qytetarët mund të telefonojnë për çdo problem. Disa zyra nëpër dikastere të veçanta janë grabitur. Nga shumë rrethe të Jugut vijnë lajme për thyerje dhe grabitje bankash e institucionesh të tjera publike e shtetërore. Banditët e armatosur kontrollojnë ende jetën dhe rrugët në këto qytete.

17 Mars 1997

Presidenti Berisha dhe Kryeministri Fino dalin me një deklaratë të përbashkët pas një takimi ku diskutuan për situatën në vend. Në këtë deklaratë nënvizohet se rruga më e mirë për kapërcimin e krizës është rruga e pajtimit kombëtar.

Flitet se Bashkim Driza, ish-president i fondacionit “Populli”, largohet nga Shqipëria me një helikopter të SHBA-ve, së bashku me disa shtetas të tjerë, në kuadrin e operacioneve amerikane për evakuimin e shtetasve të vet nga ky vend.

Në brigjet italiane mbërrijnë me qindra qytetarë shqiptarë me mjete nga më të ndryshmet. Rojet bregdetare italiane u shpëtojnë jetën më shumë se 850 refugjatëve.

Nga rrethe të ndryshme të vendit vijnë lajme për dhjetëra të vrarë e të plagosur me armë zjarri.

18 Mars 1997

Në Gjirokastrë dhe Sarandë ndodhin vjedhje masive të iniciuara nga eksponentë të komiteteve. Banditë të armatosur dhe me maska thyejnë bankën në Sarandë dhe vjedhin prej aty tre arka me para. Edhe në Gjirokastrë shkatërrohet dhe grabitet filiali i Bankës Bujqësore. Para dy ditësh në këtë qytet qe thyer e grabitur edhe Banka Kombëtare Tregtare.

Në harkun kohor të 24 orëve, në të gjithë vendin shënohen 14 të vrarë, nga të cilët katër janë fëmijë. Vetëm në Gramsh u vranë pesë vetë. Në Pukë, një fëmijë 12 vjeç vritet nga vëllai i tij 12 vjeç, teksa po luante me një armë automatike. Në Mirditë, një fëmijë 10 vjeç vrau motrën e tij 14 vjeçe duke menduar se arma që mbante në dorë nuk kishte më plumba. Në Vlorë bien viktimë e lojës me një granatë tre fëmijë; njëri prej tyre vdes në vend, ndërsa dy të tjerët plagosen rëndë.

19 Mars 1997

Situata vazhdon të jetë e tensionuar; vijnë shumë lajme për të vrarë e të plagosur nga pothuajse të gjitha rrethet e vendit. Në Lezhë mësohet të jenë të shtruar në spital mbi 50 persona të plagosur me armë zjarri. Në Shkodër zhvillohet një manifestim

nën moton “Jo plumba, por lule”. Nga Bajram Curri vijnë lajme për mungesë ushqimesh në treg.

Shteti fqinj, Italia, njofton se do të riatdhesojë afro 300 kriminelë, të cilët pasi kishin dalë nga burgjet shqiptare, kishin shkuar në këtë vend së bashku me qindra persona të tjerë në rrugë klandestine.

Zëvendësministri i Jashtëm i Greqisë, Karolos Papoulias (Krandidiotis), bën një vizitë të palajmëruar përmes kanaleve diplomatike në Gjirokastër dhe Sarandë.

20 Mars 1997

Plumbat çojnë në varr katër vetë në harkun kohor të 24 orëve të fundit. Këta persona u vranë në Korçë, Pukë, Fier dhe Tiranë.

Rihapet Aeroporti i Rinasit. Si fillim i punës së këtij aeroporti mund të konsiderohet ulja e disa helikopterëve ushtarakë italianë, që sollën në Shqipëri rreth të gjykuar si të rrezikshëm nga Roma zyrtare.

Flota italiane shpëton një peshkarexhë shqiptare me 350 klandestinë. Në këtë peshkarexhë, që rrezikonte të mbytej, ishin rreth 45 fëmijë, bëjnë të ditur këto burime. Nga shumë qytete të vendit vijnë lajme për mungesa të theksuara të artikujve ushqimorë. Vala e dhunës dhe e shkatërrimeve nuk ka kursyer as depot e grurit dhe magazinat e ushqimeve të tregtarëve të vegjël e të mesëm. Lëvizja nëpër rrugët nacionale është me shumë rrezik për shkak të pranisë në to të banditëve të armatosur që plaçkisin e vrasin.

Në Brindisi arrestohet një i ri shqiptar, i cili kapet me armë. Ai quhet Çlirim Despoti dhe akuzohet për organizimin e emigracionit ilegal nga Shqipëria për në Itali.

21 Mars 1997

Vriten dy adoleshentë nga shpërthimi që ndodhi në një depo baroti në një kazermë të Lezhës. Dy të rinjtë që gjetën vdekjen kishin dashur të ndriçonin depon me anë të një shkrepëseje, por ajo është ndezur dhe ka shpërthyer menjëherë. Gjatë 24 orëve të fundit ka pasur 13 të vrarë me armë zjarri, qoftë nga pakujdesia, qoftë edhe për larje hesapesh mes bandave rivale. Një burim nga Spitali i Tiranës bën të ditur se në repartin e djegieve të këtij spitali janë shtruar këto ditë mbi 40 fëmijë me plagë të rënda djegiesh, të shkaktuara nga shpërthimet e pakontrolluara.

22 Mars 1997

Nga Saranda vijnë lajme jo të mira. Situata atje është krejtësisht jashtë kontrollit të policisë. Kriminelët kanë sulmuar banesat e braktisura të qytetarëve. Në spitalin e këtij qyteti njoftohet se ka mungesë të theksuar të medikamenteve më të domosdoshme për kurimin e të sëmurëve. Në Gjirokastër mësohet se ka pasur gjatë natës shumë të shtëna armësh, por pa ndonjë vrasje. Komisariati i policisë së këtij qyteti u riorganizua, duke përfshirë në efektiv edhe shumë ish-oficerë të liruar prej shumë vitesh.

Lajme aspak të mira vijnë nga shumë qytete të vendit, ku sërish ka pasur mbi 15 të vrarë me armë zjarri. Shumë prej investitorëve të huaj që operonin në Shqipëri po largohen. Banditët e armatosur

që sulmuan institucionet publike e shtetërore nuk i kanë kursyer në këto sulme as investitorët e huaj.

23 Mars 1997

Rihapet porti detar i Durrësit. Gjatë 24 orëve ka 16 të vrarë në rrethet e ndryshme të vendit. Policia po e merr veten me vështirësi, pasi goditjet ndaj saj kanë qenë mjaft të rënda. Bandat e armatosura, të prira nga militantët e majtë, kanë djegur, shkatërruar dhe grabitur gjithçka. Shumë vende perëndimore ofrojnë ndihmën e tyre për policinë shqiptare, ndërkohë që në Shqipëri ajo akoma vazhdon të goditet nga banditë që urdhërohen nga krerët e PS-së dhe të disa partive të tjera të majta. Nga spitale të ndryshme të vendit vijnë lajme se nuk ka më shtretër bosh, pasi numri i të plagosurve me armë zjarri që janë shtruar ka kapur shifra shumë të larta. Në shumë nga këto spitale mungojnë edhe ilaçet.

Në afërsi të Sazanit mbyten në det pesë persona. Ndërkohë, nga Brindisi mbërrin një lajm se atje ka mbërritur një anije shqiptare me 160 vetë në bord.

24 Mars 1997

Bandat terroriste vrasin në Vlorë tre policë. Rreth orës 20:30 disa persona të armatosur rrëmbejnë një automjet tip "Benz" para godinës së komisariatit të policisë së këtij qyteti. Oficeri i policisë Spiro Toshi, së bashku me policët Besim Manoli dhe Gëzim Shabani, vihen në ndjekje të grabitësve të armatosur. Mirëpo, sapo grabitësit i shohin se po i ndjek policia, qëllojnë me breshëri

automatike në drejtim të uniformave blu, duke i lënë të vdekur në vend të tre punonjësit e policisë.

Në Berat, bandat kriminale të udhëhequra nga një komunist me mbiemrin Hasani terrorizojnë qytetarët. Këta banditë të armatosur kanë grabitur shtëpi dhe kanë rrëmbyer fëmijë. Në këtë qytet, banditët kanë pushtet të plotë. Krerët e Prokurorisë së Përgjithshme dhe ata të Gjykatës së Kasacionit, bazuar në amnistinë e ligjëruar nga Kuvendi Popullor, propozojnë një amnisti të gjerë.

Fillojnë të vijnë ndihma humanitare nga Italia dhe Franca.

Ministria e Brendshme reagon ashpër kundër një deklaratë të Sekretarit të Shtetit pranë këtij dikasteri, Lush Përpali, i cili gjatë një interviste në TVSH kërkoi që në vend të strukturave ligjore të pushtetit lokal të instalohen komitetet e ashtuquajtura të shpëtimit. Kjo ministri, në një deklaratë të saj, shprehet se rendin do ta vendosin vetëm strukturat e shtetit ligjor. Ajo bën thirrje që të respektohen strukturat e pushtetit lokal që janë zgjedhur me votën e lirë.

25 mars 1997

Në Vlorë, banditët e armatosur që vranë një ditë më parë tre policë, marrin peng katër mjekë italianë të Kryqit të Kuq, që kishin mbërritur aty për të ndihmuar popullatën.

Banditët u kanë vënë si kusht mjekëve italianë dërgimin në Itali të njërit prej anëtarëve të kësaj bande, i cili u plagos një ditë më parë në përleshje me policinë.

Ambasada Italiane në Tiranë njofton se ka urdhëruar dërgimin në Vlorë të një helikopteri për të transferuar për në Itali mjekët dhe

banditin e plagosur.

Njëri prej mjekëve të këtij ekipi, i quajtur Paulo Kurebino, bën të ditur përmes telefonit se ata gjenden të rrethuar nga jo më pak se dhjetë persona të armatosur me kallashnikovë dhe mitralozë, të cilët i mbanin nën shënjestër deri në realizimin e plotë të kërkesave të tyre.

Në mesditë, në aerodromin e këtij qyteti mbërrijnë katër helikopterë ushtarakë italianë. Njëri prej helikopterëve ulet, ndërsa tre të tjerët patrollojnë lart.

Shtatëmbëdhjetë ushtarët italianë zënë pozicionet përreth, ndërkohë që mjekët italianë dhe banditi i plagosur në kokë ngjiten në helikopter dhe nisin fluturimin drejt Italisë, pa ndonjë incident tjetër.

Një gazetare holandeze e quajtur Vima Gundobel, 39 vjeçe, plagoset rëndë me armë zjarri nga banditët e armatosur në Sarandë. Ajo dërgohet menjëherë për kurim në spitalin e Korfuzit, në Greqi. Edhe pas operimit, gjendja e saj shëndetësore mësohet të jetë tepër e rënduar dhe në rrezik për jetën.

Në Berat vazhdojnë të mbretërojnë banditët e armatosur.

Mësohet se në këtë qytet kanë ndodhur dy vrasje. Njëri është pronari i një bilardoje në hyrje të qytetit, ndërsa tjetri një 17-vjeçar nga komuna e Kutallisë. Gjithashtu, në qendër të qytetit disa banditë të armatosur dhe me maska u kanë grabitur me forcë armët dhe veshjet antiplumb një patrulle policie.

26 mars 1997

Një krim makabër ndodh në pasditën e kësaj dite në rrugën automobilistike Tiranë–Elbasan, në vendin e quajtur ura e Farkës. Disa banditë të armatosur e të maskuar, që udhëtonin me një

automjet tip “Fuoristradë” me ngjyrë të kuqe, që llojnë me armë zjarri automatike mbi një autobus pasagjerësh të linjës Tiranë–Ibë.

Nga të shtënat e këtyre banditëve plagosen shtatë persona, si dhe writen 32-vjeçari Hekuran Stalla dhe 6-vjeçarja Iris Ismetaj.

Në Gjirokastër vazhdon terrori dhe aktet kriminale. Bandat e armatosura rivale bëjnë ligjin në këtë qytet. Disa persona të armatosur, që tani kanë edhe mbështetjen e disa kontingjenteve të policisë të mobilizuara këto ditët e fundit, kanë shkëmbyer zjarr me armë në mes të qytetit. Më pas u është vënë flaka dy makinave që gjendeshin aty, si dhe janë dëmtuar disa lokale përreth.

Edhe nga Saranda vijnë lajme për bastisjen e disa shtëpive të emigrantëve që janë larguar nga frika e dhunës. Banditët e armatosur kontrollojnë edhe shumë prej objekteve publike në këtë qytet.

Në Vlorë sërish janë shënuar të vrarë, si dhe shumë të plagosur. Disa prej të plagosurve mësohet se janë përcjellë për në spitalin e Janinës, në Greqi.

27 mars 1997

Parlamenti diskuton dhe miraton një projektligj të Qeverisë së Pajtitimit Kombëtar “Për amnistinë”. Nga kjo amnisti përfitojnë mbi 700 persona të dënuar për krime të ndryshme.

Nga miratimi i kësaj amnistie të propozuar nga Qeveria e Pajtitimit Kombëtar dhe e miratuar nga Parlamenti përfitojnë të gjithë të dënuarit civilë e ushtarakë, me përjashtim të atyre që kanë kryer krime të rënda.

Madje edhe personat që kanë kryer krime të rënda, por që janë nën moshën 18 vjeç, përfitojnë nga kjo amnisti, ashtu siç përfitojnë edhe ata që janë mbi 60 vjeç, për burrat, dhe mbi 45 vjeç, për gratë.

Ky ligj përmbante edhe mjaft zbutje të masës së dënimit për ata që janë kthyer vetë në qeli.

Në mbrëmje vonë mësohet se në Levan të Fierit kanë mbetur të vrarë 18 vetë nga një përleshje e përgjakshme. Kjo tragjedi ka ndodhur pasi disa banditë të armatosur, të ardhur nga Tepelena dhe Vlora, shkëmbyen zjarr me banorët e lagjes “1 Maj” në Levan.

Ndërsa nga Gjirokastra vjen lajmi për një sulm të kryer nga disa banditë të armatosur mbi Konsullatën Greke në këtë qytet. Sulmuesit kërkonin viza greke në mënyrë të dhunshme. Ata shpreheshin se, për pajisjen me viza, kishin marrë premtime nga kjo konsullatë, ndaj edhe e kryen këtë veprim sepse nëpunësit e këtij institucioni nuk kishin mbajtur fjalën e dhënë.

Nga Vlora vjen lajmi se disa rebelë të armatosur kanë mbajtur peng, duke i kërcënuar me kallash, gjashtë italianë, dy prej të cilëve ishin gazetarë. Ata kërkonin evakuimin me çdo kusht për në Itali të një shoku të tyre të plagosur. Më pas, pengjet janë liruar pasi dikush ka marrë përsipër t’ua dërgojë shokun e tyre të plagosur në Greqi.

Në harkun kohor të 24 orëve shënohen mbi 30 të vrarë në të gjithë vendin.

Lajmi për amnistinë është “përshëndetur” me breshëri armësh të kalibrave të ndryshëm, breshëri këto që kanë vazhduar deri pas mesnate.

28 mars 1997

Tragjedi e madhe në kanalin e Otrantos në detin Adriatik. Një motobarkë e nisur nga Vlora me mbi 100 vetë mbytet në det. Shumica e të mbyturve mësohet se janë fëmijë dhe gra. Ngjarja u mësua në orët e vona të natës, pasi, siç flitet, motobarka është mbytur rreth orës 19:00. Marina italiane thuhet se ka arritur të shpëtojë 34 persona, ndërkohë që janë gjetur katër kufoma.

Pas mesit të natës mësojmë se motobarka shqiptare është përplasur me anijen luftarake italiane “Sibilla”. Ndërsa disa media italiane deklarojnë se motobarka është goditur me paramendim nga anija luftarake italiane “Sibilla”.

Burime nga Vlora thonë se motobarka është mbushur me njerëz në Vlorë dhe është nisur nën përkujdesjen e Zani Çaushit dhe Arben Malajt, të cilët, siç flitet në këtë qytet, u kanë marrë çdo personi një shumë të konsiderueshme parash, gjoja për t’i përdorur këto para për pensionistët e këtij qyteti.

Në Vlorë, vetëm disa orë para se të mbytej kjo motobarkë, janë mbledhur disa eksponentë të Komiteteve rebele dhe të disa partive politike, kryesisht të majta, dhe disa spiunë të ish-Sigurimit të Shtetit komunist, ku së bashku me ta ishte edhe Sabri Godo. Këtë mbledhje ata e kanë vetëcilësuar si Komitet të Shpëtimit Kombëtar dhe kanë nënshkruar edhe një ultimatum me disa pika, ku ndër të tjera kërkojnë edhe dorëheqjen e presidentit Sali Berisha.

Në darkë mësohet se pesë persona të armatosur kanë sulmuar godinën e Radio Vlorës, duke lënë të vrarë rojën e këtij institucioni.

Në Gramsh bastiset një depo armësh. Grupe njerëzish të armatosur, të prirë nga militantë dhe drejtues të PS, PDS dhe PAD lokale, duke vënë para gra dhe fëmijë, kanë arritur të hyjnë në një depo armatimi të ushtrisë, në fshatin Çekrez të këtij rrethi, fshat ky që është 3 km larg qytetit. Sipas njoftimeve që vijnë nga ky qytet, kjo depo më parë ishte braktisur nga forcat e ushtrisë që kishin detyrë ta ruanin dhe ta mbronin atë.

Policia njoftoi dikasterin e Ministrisë së Mbrojtjes, por nga kjo ministri nuk u mor asnjë masë dhe madje nuk iu dha ndihmë policisë për të penguar këtë bastisje. Pas një rezistence prej disa orësh, këto grupe njerëzish të armatosur, duke vënë para gra dhe fëmijë, arritën të hyjnë në këtë depo dhe të grabisin prej aty të gjitha armët dhe municionin.

Nga Italia vjen një lajm për ndalimin nga policia e këtij vendi fqinj të 14 shqiptarëve që u kapën me marijuanë. Atyre iu kapën edhe shumë armë, thekson ky burim. Burime policore italiane nënvizojnë faktin se po hetohet mbi pistën e një bashkëpunimi mes bandave të Kamorrës dhe kriminelëve shqiptarë që organizuan trazirat në jug të Shqipërisë.

Njoftohet për të vrarë në Kukës, Shkodër dhe Laç.

29 Mars 1997

Presidenti Sali Berisha i kthen Parlamentit për rishqyrtim ligjin "Mbi Amnistinë".

Hakmarrja trondit Shkodrën. Vriten pesë persona. Kjo vrasje flitet se është kryer në shenjë hakmarrjeje për një vrasje që ka ndodhur disa ditë më parë në lagjen "Liria" të këtij qyteti.

Në Berat grabitet tregu ushqimor dhe shënohen tre të vrarë. Dy banorë të këtij qyteti mësohet se kanë humbur jetën nga

shpërthimi i një bombe, ndërsa një grua ka mbetur e vdekur aksidentalisht nga një plumb, ndërkohë që kishte dalë dhe po qëndronte në ballkonin e shtëpisë së saj. Numri i të vrarëve në këtë qytet mësohet se, në harkun kohor të një muaji, i ka kaluar të 60 vetët, ndërsa të plagosurit brenda këtij harku kohor i kanë kaluar të 350 vetët. Banditët e armatosur kanë sulmuar dhe grabitur tregun ushqimor dhe magazinat e komunales, ku kanë vjedhur edhe arkivolet e gatshme që gjendeshin aty.

Një burim nga Italia bën të ditur se në Spitalin e Barit ka vdekur 30-vjeçari nga Vlora, Geron Alia, i cili ishte plagosur gjatë një përleshjeje me armë me policinë.

## **Shënim në vend të epilogut**

Ligji mbi Amnistinë u miratua. Pra krimi triumfoi mbi shtetin. Triumfoi edhe me ligj. Që nga kjo ditë unë nuk isha më i rregullt me bllokun tim të shënimeve, ku shkruaja në mënyrë të përpiktë ngjarjet më të rëndësishme sipas meje. Kjo pasi unë personalisht kurrë nuk kam menduar se duhet toleruar apo falur ata që vrasin qytetarë të pafajshëm, ata që djegin bashki e komisariate policie, ata që hapin depot ushtarake dhe grabisin armët, ata që marrin peng tregtarë e qytetarë për qëllime përfitimi. Pushteti pra u mor me grykën e pushkës. Votat në Parlament vetëm sa e ligjëruan një pushtet të tillë. Dhe një pushtet i marrë me grykën e pushkës mbahet vetëm me grykën dhe madje nuk dorëzohet ndryshe veçse përmes grykës së pushkës.

Ajo çka më detyroi t'i lë shënimet dhe të humb shpresat qenë edhe “vizitat” dhe “miqësitë” e reja që nisi të krijojë kryeministri Bashkim Fino. Në zyrën e tij nisën të trokasin të djathtë e të majtë që e kanë ves të kahershëm që pushtetin ta përdorin për përfitime pasurore. Këta “zanatlinj me eksperiencë” ia mbushën mendjen plot kryeministrit Fino lidhur me domosdoshmërinë e propozimit të disa listave të gjata për dekret-falje presidentit Sali Berisha. Këto falje u firmosën, faturën e tyre padrejtësisht e pagoi Berisha, ndërsa përfitimet e majme pasurore nga këto para gjaku i vjelën “zanatlinjtë”.

Pra tani, pasi kanë kaluar katër vjet, vendosa t'i përmbledh në një libër këto shënime. Kjo me qëllimin e vetëm për të mos harruar. Populli thotë: gjërat që harrohen mund të përsëriten.

-----

## **NDREK GJINI**

Lindi në fshatin e Bregut të rrethit Pukë më 1 Tetor 1963.

Shkollën e mesme e kreu në qytetin e Fushë-Arrëzit.

Mbaroi studimet e larta në Universitetin “Luigj Gurakuqi”,

Shkodër, Dega Gjuhë-Letërsi.

1988 punon si mësues letërsie në shkollën e mesme Iballë, Pukë.

1989–1990 punon si gazetar-redaktor në gazetën “Përpjekja” në Pukë.

1991 punon si redaktor e më pas si kryeredaktor në gazetën “Kombi”, Tiranë.

1992–1994 punon gazetar në Agjencinë Telegrafike, Tiranë.

1994–1996 punon gazetar në gazetën “Rilindja Demokratike”, Tiranë.

1996–1997 punon zëdhënës i Ministrisë së Brendshme, Tiranë.

1997–2001 punon gazetar në gazetën “Rilindja Demokratike”.

Shkruan dhe boton poezi, publicistikë dhe ese.

Është i martuar dhe ka dy fëmijë.

**Tiranë, 1998**